

CURRICULUM VITAE

Mobile: +355 694040585; e-mail: elton.haxhi@gmail.com



Elton Haxhi

Profesioni: Auditues Ligjor

Datëlindja: 21 Qershor 1972

Shtetësia: Shqiptar

Cilësitë kryesore:

Ka më shumë se 25 vjet eksperience si ekspert kontabël, auditues ligjor, ekspert financiar dhe politike-bërës. Ka ushtruar për 30 muaj detyrën e Zv.Ministrit të Financave dhe Ekonomisë përgjegjës për çështjet fiskale, administrimin e të ardhurave, kontabilitetin, auditimin, kontrollin financiar etj. Si rrjedhojë e angazhimit të tij me dy nga kompanitë Big4 dhe drejtimin prej një dekade të një prej 10 kompanive më të mëdha të auditimit dhe konsulencave në bote ai ka fituar një eksperience të gjatë në drejtimin e angazhimeve në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe konsulencave të tjera financiare. Ai është i pajisur me njohuri të thella në politika publike, mbikëqyrje institucionale, raportim financiar sipas SNRF dhe SKK.

Ai mban titullin Auditues Ligjor, anëtar i IEKA që prej vitit 2001 dhe ka ushtruar këtë profesion si drejtues auditimi me Ernst & Young në Tiranë, KPMG në Moske dhe Nexia Albania në Tiranë.

Njohes i mire i mbikëqyrjes publike pasi gjatë karrieres së tij ka qënë nje nga anetaret e pare te Bordit te Mbikqyrjes Publike.

Ka drejtuar punën qeverisëse në disa iniciativa ligjore dhe ka përfaqësuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërmjet të tjerave në disa bashkëpunime të rëndësishme me Komisionin Evropian, FMN, Bankën Botërore dhe OECD.

Aktiviteti profesional i lidhur me pozicionin që kandidon:

Drejtimin e politikave si Zv.Ministër dhe kryesimin e grupeve të punës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sa vijon:

- Drejtimin e punës, në bashkëpunim me FMN, për hartimin për herë të parë të Strategjisë Kombëtare Afatmesme për të Ardhurat (MTRS) e cila përfshin politikat fiskale dhe administrimin tatimor;
- Drejtimin e punës për anëtarësimin e Shqipërisë në Kuadrin Gjithëpërfshirës (BEPS) deri në firmosjen e marrëveshjes për Multilateral Instrument (MLI) me Z. Angel Gurría sekretar i përgjithshëm i OECD në 28/05/2019;
- Drejtimin e punës për miratimin e ligjit dhe akteve nënligjore për Shkëmbimit Automatik të Informacionit për qëllime tatimore (AEOI) në kuadër të bashkëpunimit me OECD;
- Drejtimin e punës për miratimin e ligjit dhe akteve nënligjore për Fiskalizimin;
- Përgjegjës për gjithë ndryshimet në politikat tatimore dhe paketat fiskale në vitet 2018-2020;

- Drejtimin e procesit të ndryshimeve ligjore dhe adresimit të dobësive nga vlerësimi i FATF dhe MoneyVal në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për këtë qëllim, drejtimin e punës për hartimin e kuadrit ligjor në lidhje me regjistrin e Pronareve Përfitues;
- Drejtimin e negociatave për anëtarësim (procesi pre-screening) në Bashkimin Evropian për: Kapitullin 6 (Legjislacioni Tëgtar, Kontabiliteti dhe Auditimi); Kapitullin 16 (Taksimi), Kapitulli 29 (Doganat) dhe Kapitulli 32 (Kontrolli Financiar);
- Kryetar i Komitetit Drejtues për zbatimin e projektit të Bankës Botërore për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS);
- Kryetar i Komitetit Drejtues për zbatimin e projektit të Bankës Botërore për përmirësimin e cilësisë së Raportimit Financiar të Korporatave (EQ-FINREP);
- Zv.Ministër përgjegjës për monitorimin e punës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Drejtimin e shume angazhimeve të auditimit dhe raportimit financiar për Institucione me Interes Publik sipas SNRF, në pozicionin si drejtues në shoqëri auditimi dhe konsulencash.

Të tjera detyra të lidhura me pozicionin që kandidon:

2014-2017: Anëtar i Këshillit Tatimor Kombëtar. Këshilli është një organ pranë Ministrisë së Financave me pjesëmarrës biznes-qeveri që luan rol konsultativ për çështjet tatimore.

2009-2013: Anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Bordi është një organ ligjor përgjegjës për mbikëqyrjen e audituesve ligjor dhe kontabilistëve të miratuar.

2018-2020: Kryetar i Këshillit Mbikëqyrjes të AgroKredit një shoqëri në sektorin mikrofinanciar.

2018-2020: Anëtar i Këshillit Mbikëqyrjes të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Edukimi:

1991-1995: *Diplomë, Financë Kontabilitet, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës*

1999-2000: *Auditues Ligjor, Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar (IEKA).*

Maj 2019: *Edukim për Drejtues, Harvard Kennedy School, Drejtimi i Rritjes Ekonomike.*

Historiku i Punësimit:

Data	Mars 2022 – deri tani
Vendi	Shqipëri
Institucioni	Nexia Albania Sh.p.k. (anëtare e Nexia International)
Pozicioni	Administrator dhe Auditues Ligjor
Përshkrimi i detyrës	Administrim i gjithë aktiviteve të shoqërisë dhe përgjegjës për sigurimin e cilësisë së auditimeve dhe raportimit financiar ndërmjet të cilave dhe disa institucione financiare jo-banka.

Data	Korrik 2020 – Dhjetor 2020
Vendi	Shqiperi
Institucioni	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Pozicioni	Ekspert
Përshkrimi i detyrës	Ekspert financiar ne zbatimin e Administrimit te Integruar dhe Sistemit te Kontrollit (IACS) perdorur per ndihmen financiare nga fondet e bujqesise se Bashkimit Evropian per fermeret.

Data	Tetor 2017 – Shkurt 2020
Vendi	Shqiperi
Institucioni	<u>Ministria e Financave dhe Ekonomise</u>
Pozicioni	Zevendes Minister
Përshkrimi i detyrës	Pergjegjes per politikat fiskale, administrimin e te ardhurave, manaxhiminin e financave publike, kontabilitetin, auditimin, kontrollin financiar, administrimin e shoqerive me kapital shtetoror dhe te tjera.

Data	Maj 2009 – Tetor 2017
Vendi	Shqipëri
Institucioni	Baker Tilly Albania Sh.p.k. (anëtare e Baker Tilly Intl.)
Pozicioni	Themelues dhe Partner Kryesor
Përshkrimi i detyrës	Drejtimit, menaxhimi dhe mbikqyrja i aktiviteteve dhe sherbimeve te ofruara nga Baker Tilly ne Shqiperi, perfshire auditimin ligjor te Shoqerive me interes publik, institucioneve financiare dhe shoqerive ne sektorin energjistik.

Data	Shkurt 2008 – Mars 2009
Vendi	Rusi
Institucioni	KPMG ltd
Pozicioni	Manaxher
Përshkrimi i detyrës	Drejtimit, menaxhimi dhe mbikqyrja i aktiviteteve dhe sherbimeve te ofruara nga KPMG ltd ne Rusi, perfshire auditimin ligjor te shoqerive me interes publik, institucioneve financiare, dhe shoqerive te transportit ajror.

Data	Janar 2003 – Nëntor 2007
Vendi	Shqiperi
Institucioni	Ernst & Young Certified Auditor Sh.p.k.
Pozicioni	Nga Asistent Manaxher ne Manaxher
Përshkrimi i detyrës	Drejtimit, menaxhimi dhe mbikqyrja i aktiviteteve dhe sherbimeve te ofruara nga E&Y ne Shqiperi dhe Kosove, perfshire auditimin ligjor te shoqerive me interes publik dhe institucioneve financiare.

Data	Janar 2001 – Dhjetor 2002
Vendi	Shqipëri
Institucioni	Auditues ligjor person fizik
Pozicioni	Auditues ligjor
Përshkrimi i detyrës	Kryerja e auditimit ligjor dhe konsulenca tatimore per rreth 20 shoqeri tregtare ne shqiperi.

Data	1994 – 2000
Vendi	Shqipëri
Institucioni	Banka e Kursimeve dhe disa kompani te tjera tregtare
Pozicioni	Financier ne shoqëri tregtare dhe officer kredie ne banke
Përshkrimi i detyrës	Mbajtja e regjistrimeve kontabile, raportim financiar, deklarata tatimore, dhe analiza dosje kredi-kerkuesish.

Gjuhët:

Shqip
Anglisht
Italisht

Lexim

Shkëlqyeshëm
Shkëlqyeshëm
Shumë mirë

Të folur

Shkëlqyeshëm
Shkëlqyeshëm
Shumë mirë

Shkrim

Shkëlqyeshëm
Shkëlqyeshëm
Mirë

Drejtuar: Asamblesë së Përgjithshme të IEKA

Nga: Elton Haxhi

Të nderuar anëtarë të institutit,

Jam një anëtar me kontribute 25 vjet në këtë institut. Nuk kam mbajtur apo kërkuar asnjëherë votën për pozicione drejtuese në IEKA për shkak të bindjes: mos zë vendin e dikujt tjetër që ka kohën dhe perkushtimin e nevojshme për drejtimin e IEKA. Kështu që ashtu si shumë prej jush, kam vëzhguar si çdo anëtar, drejtimin e këtij instituti nga anëtare dhe Kryetarë për 25 vjet. Kam përjetuar me keqardhje transformimin nga një sistem me një organizatë të fuqishme por pa mbikëqyrje publike, në një sistem me mbikëqyrje të fortë publike por me një organizatë të dobët, që arriti në nivele qesharake shkeljesh statutore apo edhe ligjore. Shkelje që vijnë, transparence e munguar dhe mos-përfshirje e anëtarësisë.

Besoj se përveç integritetit dhe cilësive drejtuese që shumë prej nesh i zotërojnë, përkushtimi është një domosdoshmëri për një anëtar të KD, të cilën pak e kanë. Shumë prej nesh kanë angazhime intensive në kabinetet që drejtojnë, duke e konsideruar drejtimin e IEKA vetëm si një titull honorifik. Kjo mendësi duhet të përfundojë pasi nuk na shërben. Drejtimi i IEKA kërkon njerëz të përkushtuar që japin kontribute konkrete. Përfaqësimi në KD nuk duhet të vijojë të jetë çështje qokash pasi jemi në të parët që vuajmë pasojat e një drejtimi të dobët.

Forcimi i rolit dhe reputacionit të IEKA është një prioritet në fazën ku jemi dhe një parakusht për një mbrojtje më të mirë për të gjithë anëtarët. Një mbrojtje që drejtimi i IEKA duhet ta ofrojë në dy nivele: ndaj rrezikut të brendshëm që vjen nga vetë drejtimi apo anëtarësia; dhe rrezikut të jashtëm.

Kam bindjen se në këtë fazë të karrierës time profesionale, zotëroj gjithë cilësitë që duhen për drejtimin e këtij instituti:

- Integritet të lartë dhe kohën e nevojshme për tu dedikuar.
- Eksperiencë 25 vjeçare kombëtare dhe ndërkombëtare në auditim dhe konsulencë.
- Eksperiencë në qeverisje dhe politike-bërje.
- Eksperiencë në mbikëqyrje publike si një prej anëtarëve në themelimin e BMPs (2009-2013).

Për më shumë detaje, Ju lutem gjeni bashkëngjitur një Curriculum Vitae të plotë.

Tre prioritete: Për një IEKA të fortë, gjithëpërfshirëse dhe me reputacion të lartë

Përkushtim ndaj forcimit të rolit dhe reputacionit të IEKA

- Promovimi i IEKA-s si zë kryesor profesional
- Bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare
- Përmirësim i komunikimit publik dhe reputacionit të institutit

Mbrojtja e interesave të anetaresise

- Advokim për ceshtje profesionale
- Mbështetje praktike për anëtarët (trajnime, modele pune)
- Rregullime ligjore dhe nën-ligjore që adresojnë nevojat e anëtarësise

Gjithëpërfshirja e anëtarësisë dhe respektimi i ligjit dhe statutit

- Nxitja e transparencës dhe pjesëmarrjes së çdo anëtari
- Fuqizimi i brezit të ri përmes mentorimit
- Përfaqësim i barabartë i të gjithë anëtarëve
- Përforsim i mekanizmave të qeverisjes së brendshme
- Respektim i ligjit dhe statutit në veprimtarinë e institutit

Me respekt,
Elton Haxhi